



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 245, datë 29.12.2021

**PËR
MIRATIMIN E ZMADHIMIT TË KAPITALIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT
“EUROSIG” SH.A., MIRATIMIN E PJSËMARRJES INFLUENCUESE DHE
NDRYSHIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË SË SIGURIMIT “EUROSIG” SH.A.**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 22, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 49 dhe nenit 57, të Ligjit nr. 52, datë 22.05.2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”, si dhe Rregullores nr. 138, datë 21.12.2015 “Për miratimin ose refuzimin e ndryshimeve thelbësore të statutit të shoqërisë së sigurimit”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Miratimin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a.**
- 2. Miratimin e pjesëmarrjes influencuese të aksionarit shoqëria “Euro-Alba-Ea” sh.p.k., në shoqërinë “Eurosig” sh.a.**
- 3. Ndryshimin e statutit të shoqërisë së sigurimit “Eurosig” sh.a., si rezultat i ndryshimit të neneve 7, 16, 19, 29, sipas materialit bashkëlidhur.**
- 4. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit, për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin METE**

Miratimin e ndryshimeve të statutit të shoqërisë së sigurimeve “Eurosig” sh.a., nenit 7, nenit 16, nenit 19 dhe nenit 29, si më poshtë:

“Neni 7 Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2,765,650,000 (dy miliard e shtatëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë) lekë. Ai është i ndarë në 276,565 (dyqind e shtatëdhjetë gjashtë mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e pesë) aksione të themeluesve të shoqërisë, të cilat janë të së njëjtës kategori me vlerë nominale 10,000 (dhjetëmijë) lekë, për çdo aksion.

Aksionet janë të numëruara nga 1 deri në 276,565 përfshirë numrin e fundit të aksionit.

Pjesëmarrja e aksionarëve në kapitalin themeltar të shoqërisë është si më poshtë:

Nr.	Emri Mbiemri	Përqindja	Numri i aksioneve	Vlera në lekë
1.	Kadri Morinaj	58.207 %	160,981	1,609,812,271
2.	Shoqëria “EURO-ALBA.EA” Sh.p.k.	25.693 %	71,059	710,590,000
3.	Xhevdet Morina	15.819 %	43,749	437,487,729
4.	Ylli Merkaj	0.281 %	776	7,760,000
	Totali	100 %	276,565	2,765,650,000

Aksionarët kanë të drejtën e fitimit (dividendit) mbi bazën e përqindjes së aksioneve që ata zotërojnë në shoqëri.

Shoqëria është krijuar dhe funksionon me motiv fitimin, megjithatë në rastet e humbjes, ajo mbulohet gjithashtu proporcionalisht me kontributin themeltar në aksione.”

Neni 16 Këshilli Mbikqyrës

16.1 Këshilli Mbikqyrës ushtron funksione mbikëqyrje dhe ka këto të drejta e përgjegjësi lidhur me:

a. zbatimin e legjislacionit në fuqi nga shoqëria e sigurimit;

b. miraton dhe duhet të garantojë një mbikqyrje të matur për zbatimin e politikave, strategjive dhe sistemeve të administrimit të rrezikut;

c. krijimin e sistemit të kontrollit dhe auditimit të brendshëm për të gjitha fushat e veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit, si dhe funksionimin e tyre në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 52/2014;

d. mbikqyrjen e administrimit të riskut, ndaj të cilit shoqëria e sigurimit ekspozohet gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj;

e. garantimin e vërtetësisë dhe saktësisë së të dhënave të raporteve financiare dhe statistikore të shoqërisë së sigurimit, si dhe raporteve të tjera të kërkuara nga Autoriteti apo Asambleja e Përgjithshme. Këto dokumenta duhet të miratohen e nënshkruhen nga të gjithë anëtarët e këshillit mbikëqyrës, për t`ju paraqitur Asamblesë, së bashku me një raport të këshillit për miratim dhe një përshkrim për mbikqyrjen e menaxhimit gjatë gjithë vitit financiar;

f. raportimin dhe informimin e Autoritetit Mbikëqyrës sipas dispozitave të ligjit nr. 52/2014 “Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit”;

g. të përgatisë me kërkesë të Asamblesë së Përgjithshme, marrjen e masave që janë në kompetencë të kësaj të fundit, t`i rekomandojë asaj vendime të nevojshme për t`u marrë, si dhe të zbatojë vendimet e asamblesë;

h. të thërrasë mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme sa herë vlerësohet e nevojshme në funksion të interesave të shoqërisë;

i. të japë direktiva për Administratorin për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;

j. të kontrollojë e mbikqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratori;

k. të sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël të kryhet të paktën njëherë në vit nga një Auditor i Jashtëm i pavarur dhe raporti i auditimit drejtuar asamblesë së përgjithshme t'u vihet në dispozicion të gjithë anëtarëve të këshillit dhe Administratorit;

i. të përcaktojë pagën dhe shpërblimin e administratorit;

m. të miratojë marrjen përsipër të detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 % të kapitalit të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara, nëpërmjet nënshkrimit të huave apo emitimit të obligacioneve, apo instrumentave të tjera të borxhit;

n. të vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave për themelimin e shoqërive tregtare ose grupeve të reja, sipas edhe termave të ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit risigurimit";

o. të kryejë veprime të tjera të përcaktuara në ligj dhe statut;

p. miraton ngritjen, emërimin, kompetencat dhe përgjegjësitë e Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, Komitetit të Investimeve, Komitetit të Vlerësimit të Dëmeve, Komitetit të Risigurimeve dhe vlerëson dhe nevojën për ngritjen e komiteteve të tjera.

q. Miraton rregulloret e funksionimit, zhvillimit të mbledhjeve dhe hartimit të procesverbaleve të Këshillit Mbikqyrës, Komitetit të Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut dhe komiteteve të tjera.

16.2 Këshilli Mbikqyrës përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, të cilët emërohen për një afat 3-vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Anëtarët e Këshillit emërohen nga mbledhja e përgjithshme e Aksionarëve, vetëm nëse Aksionarët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të aksioneve me të drejtë vote ose përfaqësuesit e tyre, vendosin me $\frac{3}{4}$ (tre të katërtat) e Aksionarëve që marrin pjesë në votim, sipas neneve 144, pika 1 dhe 145, pika 1, të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar.

16.3 Në emërimin e anëtarëve të Këshillit merren parasysh kërkesat për përshtatshmëri dhe aftësi të parashikuara në nenin 17 të ligjit nr. 52/2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", kriteret e parashikuara në nenin 20 të ligjit të sipërcituar dhe rregullores përkatëse të AMF nr.137, datë 21.12.2015, të ndryshuar, si dhe pajtueshmërinë e nenit 13 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar. Gjithashtu, anëtarët e këshillit mbikqyrës duhet të shmangin interesin privat, i cili krijon konflikt me interesin e "Eurosig" sh.a..

16.4 Anëtarët e këshillit duhet të jenë të ndryshëm nga administratori i shoqërisë.

16.5 Në mbledhjen e parë të Këshillit Mbikqyrës zgjidhet kryetari dhe zëvendës kryetari.

Neni 19 Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut-Auditi i Brendshëm

19. 1 Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut përbëhet nga jo më pak se tre anëtarë dhe ndër të tjera ka këto detyra:

a. monitoron proceset e raportimit financiar dhe vlerëson integritetin e pasqyrave financiare të shoqërisë së sigurimit;

b. monitoron mjaftueshmërinë dhe efektshmërinë e sistemit të kontrolleve të brendshme të shoqërisë së sigurimit;

- c. monitoron përshtatshmërinë dhe mjaftueshmërinë e proceseve të projektuara për të siguruar pajtueshmërinë me kërkesat ligjore dhe rregullatore;
 - d. propozon drejtuesin e njësisë së auditimit të brendshëm dhe monitoron veprimtarinë e njësisë së auditimit të brendshëm;
 - e. propozon audituesin e jashtëm dhe shqyrton e monitoron pavarësinë e shoqërisë audituese;
 - f. Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut mblidhet jo më pak se katër herë në vit në mbledhje të zakonshme si edhe në mbledhje të jashtëzakonshme sa herë thirret nga Këshilli Mbikëqyrës. Vendimet merren me shumicë votash të të gjithë anëtarëve të pranishëm, ndërsa abstenimi nuk është i lejuar. Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut, gjatë ushtrimit të funksioneve të tij, mund të ndihmohet nga ekspertë të jashtëm të zgjedhur prej tij.
 - g. Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut i raporton Këshillit Mbikëqyrës dhe e ndihmon këtë të fundit gjatë procesit vendimmarrës dhe mbikëqyrës të shoqërisë.
- 19.2 Auditimi i Brendshëm është një njësi që funksionon në mënyrë të pavarur dhe objektive për të dhënë opinion të specializuar si dhe për të përmirësuar veprimtarinë e shoqërisë së sigurimit. Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të Auditit të Brendshëm janë:
- a. Njësia e Auditimit të Brendshëm si pjesë përbërëse e sistemit të Kontrollit të Brendshëm ka për detyrë të ushtrojë një metodë të integruar dhe të disiplinuar për vlerësimin dhe përmirësimin e proceseve të qeverisjes, administrimit të rrezikut dhe kontroleve të shoqërisë;
 - b. Njësia e Auditimit të Brendshëm kryen auditimin e veprimtarisë së shoqërisë në përputhje me parimet profesionale dhe standardet e auditimit të brendshëm, kodin e etikës profesionale për audituesit e brendshëm dhe praktikën më të mira për ta.
 - c. Auditimi i Brendshëm emërohet dhe varet nga Këshilli Mbikëqyrës.
 - d. Auditimi i Brendshëm raporton gjetjet dhe rekomandimet pasi janë shqyrtuar paraprakisht nga Komiteti i Auditimit dhe Menaxhimit të Riskut tek Këshilli Mbikëqyrës, si dhe ndjek në bashkëpunim me drejtuesit e lartë të kompanisë zbatueshmërinë e tyre.
 - e. Paga e shpërblimi i Auditit të Brendshëm përcaktohet nga Këshilli Mbikëqyrës.”

Neni 29

Shoqëria e Sigurimeve “Eurosig” sh.a. e kryen aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë ose jashtë saj, nëpërmjet degëve ose agjencive, të cilat krijohen në bazë rrethi apo rajoni, me urdhër të Administratorit. Degët brenda territorit të Republikës së Shqipërisë veprojnë nën mbikëqyrjen e Administratorit.

Degët jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë funksionojnë sipas rregullave të miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.”